



Republika e Kosovës
Republika Kosova - RepublicofKosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

**të mbledhjes së dytë të Komitetit për barazi gjinore, mbajtur më 23.09.2022,
duke filluar në orën 16a:00.**

Në mbledhje morën pjesë: anëtarët e Komitetit: Violeta Salihu, Besart Krasniqi, Gëzim Mehmeti dhe Leonora Shabani – Bajraktari.

Mungoi: Dhurata Jahaj –Retkoceri

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Violeta Salihu, kryesuese e komitetit dhe propozoi këtë

Rend të ditës:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Barazi Gjinore;
2. Diskutim lidhur me fushatën për vetëdijesimin e grave lidhur me kancerin e gjirit;
3. Diskutim lidhur me fushatë që do të zhvillohet, "16 Ditët e aktivizimit kundër dhunës mbi baza gjinore";
4. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Barazi Gjinore

Kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Barazi Gjinore.

Pika e dytë

Diskutim lidhur me fushatën për vetëdijesimin e grave lidhur me kancerin e gjirit

Kryesuesja fillimisht i njoftoi të pranishmit rreth Planit të punës së komitetit e cila tha se këtë plan do ta plotësojmë edhe më tej me disa aktivitete për vetëdijesimin e grave lidhur me kancerin e gjirit edhe me aktivizimin kundër dhunës në familje. Lidhur me këtë çështje do të ishte mirë që ne ti bëjmë të paktën 3- 4 aktivitete deri në fund të vitit, por 3 nga këto aktivitete

Faqe 1 nga 3

me qenë të mira që kishin pas mesazh përcues te komuniteti. Këto takime kishim mundur me i zhvilluar në ndër kohë, e nuk janë aktivitete, por mundemi me i zhvilluar, sa i përket promovimit të punës së femrës në Kuvend Komunal, asociacionin e gazetarëve, etj. Një koordiniminim të punës për këto aktivitete do ta kemi edhe me drejtoren e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale.

Gëzim Mehmeti tha se ne si komitet nëse shkojmë me i taku mjekët dhe infermierët, qendrën e mjekësisë familjare kryesore,është kjo mundësi, por paraprakisht duhet me e bë një termin me ish drejtorin e shëndetësisë Bujar Gashin.

Premtime Preniqi tha se kjo kishte me qenë mirë në kuadër të "16 ditët e aktivizimit kundër dhunës mbi baza gjinore", për arsyen kur një viktimi e dhunës të kërkojë shërbim në atë qendër, mjeku të jetë i trajnuar për hapa që do të marrë tutje.

Gëzim Mehmeti, propozoi që në rastet e dhunës mbi baza gjinore, duhet që automatikisht policia dhe prokuroria me pas qasjen, por është çështja e mbrojtjes të drejtave të pacientit, veç me e bë një data bazë të veçantë.

Premtime Preniqi tha se nëse vërehet se është ushtruar dhunë dhe pacienti nuk dëshiron me e pranuar që me u lajmëruar rasti, ka qenë e obliguar që mjeku pasi i merr të dhënat e pacientit me lajmëruar policinë dhe policia menjëherë me shkua në shtëpinë e viktimës së dhunës.

Kryesuesja tha se do të ishte mirë që ne ta bëjmë at tryezë e aty me i ndërlidhë temat, si dhuna në familje, mënyra e raportimit prej personelit shëndetësor që është nganjëherë edhe e pamundur, pra ka mundësi të ndryshme që me e lajmëruar dhunën tek personeli mjekësor. Duhet shikuar mundësinë se si të jetë kjo tryezë pune, ti ftojmë drejtorët e QKMF-ve, edhe me pa çfarë politika kanë për raportim të rasteve, por edhe për ngacmimë seksuale.

Leonora Shabani - Bajraktari tha se më mirë është që tryeza me qenë si përmbyllja e fushatës ose edhe fillimi i fushatës, dita e parë ku do të diskutoheshin të gjitha këto çështje që për këto duhet me biseduar edhe me stafin mjekësor për të raportuar çdo dyshim

Premtime Preniqi tha se ne kemi edhe mekanizmin kundër dhunës në familje, aty përfshihet edhe Drejtoria e Shëndetësisë, Policia, Prokuroria, Gjykata, ndihma juridike falas, Agjensioni për ndihmë juridike, strehimorja, qendra për punë sociale, OJQ-të.

Kryesuesja tha se nëse e bëjmë një tryezë të tillë, duhet një linjë e veçantë buxhetore.

Premtime Preniqi tha se nëse e bëjmë ndonjë tryezë pune nëpër shkolla, aty nuk kërkohet ndonjë buxhet, se aty nëpër shkolla kanë një statistikë, çka ndodhë ma shumë në cilat shkolla ka probleme ma shumë, cilat lokacione.

Edhe ngacmimet seksuale, sulmet prej geneve, mungesa e ndriçimit të disa hapësirave, si dhe siguria në disa parqe për vajzat, grat dhe fëmijët janë evidente, të gjitha format e sulmit janë prezentë në këto hapësira.

Kryesuesja ishte e mendimit se fillimi i fushatës të jetë nëpër shkolla të mesme, ndoshta edhe në ato fillore, kryesisht me nxënësit e klasave të shtata dhe të teta, që fëmijët me ditë që duhet me lajmëruar aktet e tillë, si dhe të vetëdijesohen edhe për ngacmimet që po ju bëhen nëpër rrjetet sociale, me qenë të vetëdijshme që dënohet ai akt.

Leonora Shabani - Bajraktari, propozoi që për një tryezë pune si pilot projekte për fillim të merren 3 shkolla profesionale, si ajo e ekonomisë, teknike dhe shkolla e tregtisë, e që mendoj se në ato shkolla janë disa grupe më të diskriminuara.

Kryesuesja tha se në muajin tetor do të shohim mundësinë për mbajtjen e disa ligjératave me gratë e moshuara për vetëdijesimin e kancerit të gjirit.

Pika e tretë

Diskutim lidhur me fushatë që do të zhvillohet, "16 Ditët e aktivizimit kundër dhunës mbi baza gjinore"

Kryesuesja tha se për këtë pikë kemi menduar që ta kemi një takim me Ministrinë e Drejtësisë, me temën "Mekanizmi kundër dhunës në familje" dhe me e shikuar se çfarë aktivitete kanë ata. Po ashtu një takim tjetër është edhe me Agjensionin për informim dhe privatësi, që me kërkuar prej këtyre a minden këta me mbajte ligjérata nëpër shkolla, pikërisht në ato shkolla që i propozoi znj. Leonora, pasi që sipas statistikave që janë bë nëpër disa shkolla ka dal me numrin më të lartë të nxënësve që kalojnë në overdozë. Gjithashtu është menduar që të organizohet edhe një takim për dhunën kibernetike

Gëzim Mehmeti ishte i mendimit se fushatën për këto organizime do ta bëjmë përmes çantave e që këto çanta i shet edhe strehimorja e grave të dhunuara edhe Hendikosi dhe duhet me pa sa i shesin edhe me gjet një donator, këto çanta minden me qenë edhe material prej letre.

Prentime Preniqi tha se motoja e kësaj fushate të jetë "Unë zgjedh të jetoj i lumtur në familjen time" ose "Unë zgjedh të jetoj pa dhunë" dhe në anën tjetër të çantës të jetë edhe numri i telefonit ku mundet me u lajmëruar dhuna

Kryesuesja tha se për sigurimin e këtyre çantave ne duhet paraprakisht të takohemi edhe me drejtoren e Drejtorisë së Financave, për me e pa mundësinë e sigurimit të mjeteve financiare.

Gëzim Mehmeti po ashtu ishte i mendimit se për sigurimin e çantave duhet ti bëjmë një kërkesë me procedura të negociuara nënkytarit ose kryetarit të Komunës.

Kryesuesja tha se në mbledhjen e radhës do të ngrisim për diskutim edhe shumë çështje të tjera, si për dhunën në familje, për dhunën seksuale, për gjendjen e strehimoreve etj.

Mbledhja përfundoi në orën 17:00.

Procesmbajtësi
Arton Ibrahimî

Kryesuesja e Komitetit
Violeta Salihu



Faqe3nga3